

**BASHKIA ELBASAN**  
NJOFTIM ANKANDI

1. Autoriteti shitës: Bashkia Elbasan  
adresa: rruga "Qemal Stafa", nr.tel/fax: (+355) 54 52797 / (+355) 54 52246.
2. Data e zhvillimit të ankandit: 03.04.2024, ora 10.00
3. Lloji i Procedurës së ankandit: "Procedurë e hapur"
4. Objekti i Shitjes: Shitja në ankand e 70 % të aksioneve të Shoqërisë Tregtare Sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" Sh.A.
5. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes : Aktualisht Bashkia Elbasan është aksioner i vetëm i Shoqërisë Tregtare Sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" Sh.A, duke patur pronësinë e 100 % të aksioneve të shoqërisë. Me vendimin nr.118 datë 30.11.2023 Këshilli i Bashkisë Elbasan miratoi raportin e vlerësimit dhe autorizoi shitjen në ankand të 70 % të aksioneve të Shoqërisë Tregtare Sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" Sh.A.
6. Vlera fillestare: 13,838,650 (trembëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë.
7. Vendi i zhvillimit të ankandit (Adresa): Bashkia Elbasan, Rruga "Qemal Stafa", salla multifunkionale, kati i katërt.
8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 03.04.2024, ora 10.00
9. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë Bashkisë Elbasan, Drejtoria Prokurimeve Publike, kati i katërt, kundrejt pagesës përkatëse.

Dokumente me pagesë:

	Po	X	Jo	<input type="checkbox"/>
<i>Nëse Po</i>				
	Monedha	Lekë	Çmimi	1000

Dokumentet standarde të ankandit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;

- Formulari i ofertës;
  - Ftesa për oferte;
  - Formulari i njoftimit të fituesit;
  - Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
  - Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.